

PUNIM UDHËZUES

ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT

MAJ 2011

FORUMI MBI POLITIKAT EKONOMIKE

Përmbajtja

- 1 Sfidat
- 2 Sundimi i ligjit dhe konkurrenca
- 3 Shkathtësitë e fuqisë punëtore
- 4 Ligji i Punës
- 5 Paga Minimale
- 6 Komentet shitesë të ngritura në tryezë
- 7 Referencat

Hyrje

Përkundër krizës ekonomike globale, rritja ekonomike në Kosovë në vitet e fundit ka vazhduar të jetë pozitive (BQK, 2010; Komisioni Evropian, 2010). Mirëpo, gjatë vitit 2009 dhe gjysmës së parë të vitit 2010 vlerësohet se kjo rritje ka ardhur pothuajse plotësisht si rrjedhojë e konsumit dhe investimeve të sektorit publik (Komisioni Evropian, 2010). Duke marrë parasysh këtë dhe sfidat me të cilat përballlet ekonomia e Kosovës (të përmbledhura në numrin e kaluar), konsiderojmë se zhvillimi i sektorit privat duhet të jetë prioritet për shoqërinë kosovare.

Duke qenë se problemet që pengojnë zhvillimin e sektorëve të ndryshëm tashmë janë renditur në studime dhe raporte të panumërta, ky punim do të fokusohet më shumë në vetëm disa probleme të zgjedhura, dhe në veçanti në disa zhvillime të fundit që prekin drejtpërdrejt sektorin privat.

Synimi i këtij punimi dhe tryezës së rrumbullakët që do të pasojë është **paraqitja e mendimeve dhe përvojave të vetë bizneseve kosovare dhe asocioacioneve që përfaqësojnë ato, hapja e diskutimit** në mes të përfaqësuesve të biznesit, shoqërisë civile dhe institucioneve kosovare **me qëllim të ardhjes deri te rekomandimet** për përmirësim të kushteve për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë.

Publikuar nga:

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Instituti Riinvest dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES) falënderojnë të gjithë përfaqësuesit e bizneseve dhe asocioacioneve të bizneseve të intervistuar që kanë ndarë ekspertizën dhe përvojën e tyre me ekipin tonë gjatë realizimit të këtij projekti.

1. Sfidat

Studimet dhe raporte nga organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare (p.sh., Riinvest, vite të ndryshme; Riinvest, 2009; Banka Botërore, 2010; Komisioni Evropian, 2010) kanë identifikuar një listë të gjatë sfidash me të cilat përballet sektori privat në Kosovë, ndër të cilat më së shpeshti janë të cituar:

- niveli jo i kënaqshëm i sundimit të ligjit (përfshirë vështirësitë në zbatimin e kontratave, evazionin fiskal, korrupsionin) dhe konkurrenca jo-fer që vjen si pasojë e tij
- mungesa e energjisë elektrike
- niveli i ultë i zhvillimit të infrastrukturës
- qasja e kufizuar në financim
- mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar
- kohëzgjatja dhe/ose kostoja e realizimit të procedurave byrokratike për
 - hapje të biznesit (licenca nga Komuna, certifikata nga Agjencioni Kosovar i Bizneseve, pajisja me numrin fiskal, regjistrimi në Administratën Tatimore të Kosovës, etj.)
 - pajisje me leje ndërtimit
 - pajisje me lincenca (nga niveli qendror dhe ai lokal)
- niveli jo i kënaqshëm i mbrojtjes së investuesve të huaj
- qasja e kufizuar në tregjet e jashtme

*Ligji i punës dhe
paga minimale:
probleme të reja
potenciale*

dhe në periudhën e fundit si zhvillimet kryesore që mund të jenë potencialisht problematike janë:

- ligji i ri i punës
- paga minimale

Duke e pasur parasysh numrin dhe kompleksitetin e tyre, disa nga këto sfida, siç janë niveli i infrastrukturës dhe furnizimi me energji elektrike në veçanti, qasja në financim, korrupsioni, procedurat për pajisjen me licenca dhe leje, tërheqja e investimeve të huaja direkte (IJD) dhe aftësia konkurruese e firmave kosovare në tregjet e huaja do të trajtohen në tryeza të veçanta gjatë muajve të ardhshëm. Ndërkaq, pjesa tjetër e këtij punimi fokusohet në **sundimin e ligjit dhe pasojat në konkurrencën në treg, nivelin e shkathtësive të punëtorëve, ligji i punës, dhe paga minimale**.

Duke qenë se problemeve në këto fusha janë konstatuar si kyçe për zhvillimin e sektorit privat nga raportet e mëhershme dhe nga ky hulumtim, qëllimi i këtij punimi është që të sjell mendimet dhe përvojat e vetë bizneseve kosovare për natyrën e problemeve në këto fusha, ndikimin e tyre në të bërit biznes në Kosovë dhe masat që Qeveria qendrore dhe qeveritë lokale do të mund të ndërmerrin për t'i zgjidhur këto probleme.

2. Sundimin e ligjit dhe konkurrenca në treg

Niveli jo i knaqshëm i zbatimit të ligjit është identifikuar si një nga sfidat kryesore me të cilin përballlet sektori privat i Kosovës (p.sh. Riinvest, vite të ndryshme; Riinvest, 2009; Komisioni Evropian, 2010). Pasojat në këtë drejtim rradhiten që nga ndikimi i drejtpërdrejtë në zbatimin e kontratave deri tek problemet me evazionin fiskal dhe korrupsionin të cilat krijojnë në konkurrencë jo-fer në treg.

Zbatimi i kontratave, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe konkurrenca

Mungesa e një mekanizmi efektiv dhe eficient për të siguruar **zbatimin e kontratave** pengon zhvillimin e bizneseve në Kosovë në shumë aspekte. Se pari, bizneset pësojnë humbje për shkak të **mospërbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e blerësve ose furnizuesve të tyre**. Për shembull, një përpunues i qumështit i intervistuar raporton se firma e tij ka marrë kredi nga një institucion financiar nderkombëtar për të blerë lopë për t'i shpërndarë tek fermerët, të cilët kanë qenë të obliguar të ripagujnë një pjesë të kredisë dhe të furnizojnë firmën e tij me qumësht, të cilën gjë ata asnjëherë nuk e kanë bërë. Kompania raporton se paditë që i kanë bërë ata para tetë viteve për këtë rast janë ende të hapura. Fatkeqësisht, pasojat e problemeve të tilla janë përtej kostos së humbjes direkte që firma pëson nga mosrespektimi i kontratës nga pala tjetër. Realisht, pasiguria që sjell mungesa e zbatimit të kontratave mund të jetë **duke ndikuar që firmat të mos hyjnë në transaksione biznesore** të cilat në rrethana të tjera do të realizoheshin. Kjo gjithashtu ka të ngjarë të jetë njra nga arsyet pse shitja e mallrave me kredi nga firmat kosovare dhe blerja e inputeve të firmave me kredi janë shumë më të ulta tek firmat në Kosovë sesa tek ato në ekonomitë tjera në trazicion, në rajon dhe ato të Evropës dhe Azisë Qëndrore në përgjithësi (Banka Botërore, 2010), gjë që vështirëson blerjen e inputeve dhe shitjen e produkteve për këto firma kosovare.

Mungesa e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe "përveteësimi" i punëtorëve dekurajon aktivitetet me vlerë të lartë të shtuar

Një gjetje befasuese lidhur me çështjet ligjore është ajo e Bankës Botërore (2010) ku raportohet se përqindja e firmave që raportojnë që gjyqet nuk janë problem për bizneset është dhjetë pikë të përqindjes më e lartë në Kosovë (56%) krahasuar me mesataren e ekonomive në trazicion të Evropës Jug-Lindore (EJL) dhe në Europë e Azinë Qendrore (EAQ). Megjithatë, duke e parë gjetjen tjetër të këtij raporti se vetëm 3 përqind të firmave Kosovare kanë qenë në gjyq në tri vitet e fundit krahasuar me mesatarën e 32 dhe 27 përqind të Evropës Jug-Lindore dhe Europës dhe Azisë Qëndrore, respektivisht, një përfundim më i përshtatshëm duket të jetë që **bizneset Kosovare nuk kanë besim në sistemin gjyqësor dhe nuk e marrin atë parasysh fare gjatë marrjes së vendimeve**.

Pamundësia për të zbatuar kontratat gjithashtu ndikon në nivelin e investimeve të firmave në aftësitë e punëtorëve të tyre dhe në kapacitetet e tyre inovative. Firmat në sektorë të ndryshme raportojnë **"përvetësimin" e punëtorëve nga firmat tjera** si problem të madh. Në mungesë të mekanizmave të zbatimit të kontratave, firmat që investojnë në trajnime të shtrenjta të punëtorëve të tyre përfundojnë duke i humbur këta tek firmat konkurrene. Një problem i tillë mund të ndikojë në vullnetin e firmave të rrisin nivelin e aftësive të punëtorëve të tyre

dhe potencialisht mund të shpjegojë përse, siç diskutohet në seksionin në vazhdim, firmat Kosovare investojnë shumë më pak në trajnimin e punëtorëve të tyre në krahasim me firmat në ekonomitë tjera në tranzicion (Banka Botërore, 2010). Kjo është posaqërisht shqetësuese pasi që shkashtësitë e punëtorëve direkt ndikojnë në konkurrencën e firmave Kosovare në treg dhe pengon zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar, për të cilat nevojiten relativisht më shumë shkathtësi.

Një problem që lidhet me këtë, **mungesa e të drejtave të pronësisë intelektuale**, shihet si pengesë kyçe për biznesin nga Oda Amerikane në Kosovë (Musa, 2011), dhe posaqërisht nga kompanitë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT). Në zhvillimin e software-it, për shembull, është vështirë për firmat të parandalojnë transferin e produktit (apo një versioni pak të modifikuar) nga (ish) punëtorët tek frima konkurrente e cila pastaj e shet atë si të veten (Çavolli, 2011). Në këtë rast, problemi qëndron jo vetëm tek zbatimi i ligjit, por edhe tek pamundësia e zhvilluesit origjinal të patentojë software-in. Të drejtat e pronësisë intelektuale mund të kenë ndikim të relativisht pak firma në Kosovë aktualisht, mirëpo këto janë një parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve me vlerë të shtuar dhe një faktor kyç në gatishmërinë e investitorëve të huaj të transferojnë teknologjinë dhe shkathtësitë e tyre tek partnerët Kosovarë.

Evazoni fiskal dhe konkurrenca në treg

Politikat fiskale në Kosovë konsiderohen të favorshme sa i përket normave tatimore, mirëpo megjithatë të gjitha asociacionet biznesore të intervistuar raportojnë se ka probleme në implementim të politikës fiskale. Përveç kapaciteteve të kufizuara brenda Administratës Tatimore e cila shpesh shkakton **paqartësi në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e bazës tatimore**, si rezultat i së cilës bizneset të cilat paguajnë taksat shpesh përfundojnë duke paguar gjoba sepse ata nuk kanë qenë në gjendje t'i llogarisin mirë detyrimet e tyre tatimore. Për më tepër, paqartësitë në implementim rrisin koston (në kohë dhe para) dhe mundësitë për korrupsion.

Problemet në implementimin e politikave fiskale kanë edhe një ndikim në ambientin biznesor përmes efektit të **evazionit fiskal** në konkurrencën (e padrejtë) në tregun Kosovar. Oda Ekonomike e Kosovës konsideron evazionin fiskal si **gjenrator kryesor të konkurrencës së padrejtë në treg** (Rukiqi, 2011). Firmat e intervistuar gjithashtu raportojnë se ballafaqohen me konkurrencë shumë të ashpër nga konkurentët të cilët nuk paguajnë taksa dhe si rezultat janë në gjendje të shesin produktet e tyre me çmime shumë më të ulta.

Në një shënim të lidhur, **ritja e kohëve të fundit në shpenzimet qeveritare ka vënë presion në Administratën Tatimore dhe Doganat që t'i rrisin të hyrat**, dhe bizneset e intervistuar duket të jenë në ankth lidhur me pasojat potenciale që kjo dukuri mund të ketë në biznesin e tyre. Në anën tjetër, bizneset dhe

Lufta kundër evazionit fiskal duhet të implementohet në atë mënyrë që e përmirëson konkurrencën

Megjithatë, nën kushtet e përmendura me lart, d.m.th. aty ku ka hapësirë për korrupsion dhe aktualisht ka evazion fiskal (nga disa biznese më shumë se tek të tjerat), është e kuptueshme që bizneset kenë frikë se organet që mbledhin të hyrat buxhetore zgjedhin rrugën më të lehtë duke gjobitur kompanitë të cilat paguajnë relativisht më shumë tatime dhe/ose nuk janë të involvuara në korrupsion. Në këtë drejtim, Qeveria **duhet të përkujdeset se qasja e në luftën kundër evazionit fiskal është gjithëpërfshirëse dhe në favor të përmirimit të konkurrencës në treg.**

Dhënia e licencave dhe lejeve (nga niveli qendror dhe lokal) konsiderohet si një burim tjetër për korrupsion dhe konkurrencë të padrejtë (p.sh. në qoftë se ato lëshohen më shpejt dhe/ose më lehtë për disa firma). Numri i licencave dhe lejeve, procedurat e komplikuara dhe kostoja (në kohë dhe para) është cekur si problem serioz në Kosovë në raportin Doing Business të përpiluar nga Banka Botërore. Në mënyrë të ngjashme, tri asociacionet më të mëdha të bizneseve në Kosovë, OEK, AmCham dhe AKB, gjatë intervistave kanë ranguar këtë problem si **barrierë kryesore të të bërit biznes në Kosovë**. Duke pasur parasysh se llojet dhe licencat e ndryshme dhe procedurat dhe kostot e tyre janë janë temë shumë e gjerë për t'u trajtuar në këtë punim, **rekomandohet që mundësitë e reduktimit të barrës që këto përbëjnë për firmat duhet të analizohen nga institucionet relevante në nivelin qendror dhe atë lokal.**

3. Shkathësitë e fuqisë punëtore

Aftësitë dhe arsimimi i fuqisë punëtore është një determinantë kyçe e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Studimet e mëhershme nga Insituti Riinvest (Riinvest, vite të ndryshme; Riinvest, 2009) tregojnë se **niveli i edukimit të menaxherëve dhe punëtorëve të bizneseve private është relativisht i ulët**. Shumica prej tyre kanë shkollimin e mesëm si nivelin më të lartë të edukimit. Këto gjetje janë konfirmuar gjithashtu nga Banka Botërore (2010) e cila sugjeron se aftësitë dhe edukimi i punëtorëve është problemi më i madh i biznesit në Kosovë. Sipas kësaj ankete, 24 përqind e firmave Kosovare tregojnë se aftësitë dhe shkollimi i fuqisë punëtore nuk paraqesin problem, në krahasim me 42 përqind dhe 33 përqind në rajonin e Evropës Jug-Lindore dhe ekonomitë në tranzicion të Evropës dhe Azisë Qendrore, respektivisht. Ngjashëm, sipas anketës BEEPS të Bankës Botërore (2010), pjesa e punëtorëve të cilët kanë shkollim të lartë në rajonin e Evropës Jug-Lindore është dyfish më e lartë se sa ajo në Kosovë (15 në krahasim me 7 përqind) ndërsa ajo në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore është tri herë më e lartë (24 përqind). Përveç kësaj, **firmat në Kosovë u ofrojnë më pak trajnime punëtorëve të tyre;** në sektorin e prodhimit, pjesa e e punëtorëve të cilët marrin pjesë në trajnime në regjonin e Evropës Jug-Londore është pesë herë më e lartë në krahasim me Kosovën, ndërsa pjesëmarrja në trajnime në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore (ku aftësitë janë në nivel dukshëm më të lartë) është katër herë më e lartë në krahasim me atë në Kosovë (Banka Botërore 2010).

Niveli i edukimit dhe trajnimit të punëtorëve është shumë herë më i ulët ulët në firmat Kosovare në krahasim me ekonominë e tjera në tranzicion

Bizneset private në Kosovë gjithashtu deklarojnë se **shkathtësitë e punëtorëve të arsimuar nuk janë në nivel të kënaqshëm** (Riinvest, vite të ndryshme). Veçanërisht, firmat ndjejnë se edukimi sekondar the terciar nuk e përgatit fuqinë punëtore hyrëse për tregun e punës, pjesë e problemit janë edhe mungesa e “shkathtësive praktike”, d.m.th. zbatimi i njohurive për të zgjidhur probleme në punë. Mungesa e punëtorëve të kualifikuar duket se po ndikon në pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike. Në disa profesione si përpunimi i ushqimit dhe inxhinieria mekanike ky problem duket të jetë aq i rëndë sa që firmat raportojnë se janë të detyruar të punësojnë staf nga vendet e rajonit, gjë që ua rrit në mënyrë të konsiderueshme koston e prodhimit. Përmirësimi i kualitetit të edukimit është një faktor kyç në përmirësimin e kualitetit (dhe si rezultat konkurrueshmërinë) e produkteve dhe shërbimeve Kosovare në vend dhe jashtë. Në anën tjetër, ka raste në disa profesione (p.sh. salduesit) ku edhe pse ka punëtorë me përvojë, **afhtësitë e tyre nuk janë të certifikuara formalisht** gjë e cila (nën kushte të informatës asimetrike) e bën të vështirë për investitorët e huaj të rekrutojnë punëtorë (Rukiqi, 2011). Shembuj si ky ilustrojnë **rëndësinë e të pasurit edhe trajnime profesionale (formale)** dhe rëndësinë e të pasurit **një fuqi punëtore të kualifikuar për të tërhequr investime të huaja në vend**, veçanërisht duke ditur se niveli i aftësive të fuqisë punëtore jo vetëm që ndikon në gadishmërinë e firmave të huaja për të zhvilluar aktivitet në Kosovë, por edhe në nivelin e teknologjisë dhe shkathtësive që ata i transferojnë në vendin tonë.

Një shenjë inkurajuese për sektorin e ICT-së është raportuar nga Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë (STIKK) ku trajnime ofrohen nga kompanitë si CISCO, Microsoft dhe ORACLE. Sipas kësaj shoqate, Kosova është lidere sa i përket numrit të inxhinierëve të CISCO-s për kokë banori dhe të gjithë këta janë të punësuar (Çavolli, 2011).

4. Ligji i Punës

Ligji i punës ka efekt direkt në koston e prodhimit të sektorit privat dhe rrjedhimisht në konkurrueshmërinë e firmave kosovare në tregu, por gjithashtu edhe atraktivitetin të një ekonomie si destinacion për investimet e huaja direkte. Në përputhje me rrethanat, ligji i ri i punës në Kosovë njhet si një zhvillim i rëndësishëm nga bizneset private dhe shoqatat biznesore.

Shoqatat e bizneseve të intervistuar pohojnë që ligji i ri i punës është shkas për shqetësim në sektorin privat, edhe pse është ende heret të vlerësohet efektin e tij. Fillimisht, **ligji i ri rrit koston e mbajtjes së punëtorëve** sepse orët e punës janë më të shkurta dhe pushimet më të gjata. Së dyti, ligji rrit koston relative të punësimit të femrave për shkak të pushimit më të gjatë të lindjes

*Ligji i ri ka rritur
koston relative të
punësimit të
femrave*

(deri në një vit). Ky ndryshim, që është paramenduar të jetë në favor të grave që punojnë, ka të ngjarë të ketë efekti plotësisht të kundërt. Ky ligj **dekurajon firmat private punësimin e femrave dhe në këtë aspekt mund të konsiderohet diskriminues**. Gjatë intervistave me bizneset, një menaxher shprehet për këtë çështje:

“...është absurde për një punëtor të jetë larg vendit të punës për një vit. Nëse ky ligj nuk ndryshon, ne nuk do të punësojmë më femra në firmën tonë.”

Edhe nëse firmat vazhdojnë të punësojnë femra si më parë, ato mund të **rrisin tendenën të punësojnë femra joformalisht ose të mos iu ofrojnë atyre kontrata afatgjate**. Për më tepër, edhe nëse firmat janë të gatshëm të punësojnë femra dhe të ofrojnë pushim të gjatë të lindjes siç parashihet me ligj, nuk është në favor të femrave të punësuar të qëndrojnë larg tregut të punës për kaq gjatë sepse **dituria e tyre dhe aftësitë do të zhvlerësohen dhe mundësitë e tyre përparim në karrierë do të ulen**.

Ligji shihet si i dëmshëm për pozitën e femrave në tregun e punës **edhe ga femrat e punësuar** të cilat janë intervistuar për klëtë hulumtim. Duke i marrë parasysh të gjitha këto, **rekomandohet që ky ligj të rishikohet**.

5. Paga Minimale

Një tjetër aspekt i rregullimit të punës i cili është diskutuar kohëve të fundit është vendosja e pagës minimale. Duke e pasur parasysh rrezikun potencial të rritjes së kostos së mbajtjes së punëtorëve, kjo shihet si një çështje tjetër që është vitale për konkurrueshmërinë e firmave kosovare.

Për dallim nga çështjet tjera të diskutuara në seksionin paraprak, bizneset dhe shoqatat biznesore nuk duket të kenë opinione të forta (kundër) në lidhje me këtë çështje. Megjithatë, ato mendojnë që efektet e pagës minimale varen shumë nga niveli i pagës që vendoset, prandaj caktimi i tij duhet të bëhet me shumë kujdes. Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) thekson që paga minimale thotë që paga minimale është obligative bazuar në Konventën e Organizatës Nderkombëtare të Punës (ILO), por ajo nuk mund të shihet vetëm si mjet për luftimin e varfërisë. Në këtë aspekt, Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB) thekson që paga minimale **nuk duhet të caktohet më e lartë sesa ajo e vendeve në rajon** dhe që ajo duhet të bazohet në analiza ekonomike (Shahini, 2011). OEK gjithashtu mendon që paga minimale **duhet të reflektojë koston e punësimit të punëtorëve, nivelin e përgjithshëm të zhvillimit të ekonomisë dhe koston e jetesës**, në njërin anë, dhe në anën tjetër duhet konsideruar edhe **gadishmërinë e firmave për të paguar këtë pagë** (Rukiaqi, 2011). Përdryshe, siç thotë OEA, vendosja e pagës minimale **mund të shkaktojë që firmat të rrisin punësimin joformal** (Musa, 2011).

Paga minimale duhet të vendoset bazuar në analiza

6. Komentet shtesë të ngritura në tryezë

Bizneset pjesëmarrëse dhe organizatat e tjera janë pajtuar në masë të madhe me argumentet e prezentuara në këtë analizë politike. Gjithashtu, janë ngritur komente si ne vijim:

Sundimi i ligjit dhe konkurrenca

Lumnije Ajdini (AKB) dhe Arian Zeka (OEAK) shprehën njëloj shqetësimet e tyre lidhur me punën e **Bordit të Pavarur të Ankesave** brenda administratës tatimore i cili është i paraparë të procesojë ankesat brenda 30 ditëve, mirëpo rastet kanë tendencë të vonohen (në disa raste deri në dy apo tre muaj). Vonesat në **pagesën e TVSH-së, (mbi)vlerësimi i të mirave dhe (mungesa) e doganave në Kosovën Veriore** janë disa probleme shtesë të cekur nga AKB.

Arian Zeka (OEAK) informoi pjesëmarrësit për **themelimin e dy Qendrave të Arbitrazhit**, një tek OEK dhe tjetra tek OEAK. Staf i nevojitur për të dy qendrat është rekrutuar dhe tranjurar, dhe deri më tani dy raste janë zgjidhur. Në një shënim lidhur me këtë temë, Muhamet Mustafa (Parlamenti i Kosovës) sugjeroi se duhet të themelohen gjykata ekonomike në çdo rajon të Kosovës.

Gjithashtu është rekomanduar **një koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve Kosovare**. Për shembull, Arian Zeka (OEAK) thekson se kompanitë të cilat ofertojnë në tenderët publik duhet të marrin një **çertifikatë nga administrata tatimore për të vërtetuar se i kanë paguar taksat**, ai gjithashtu theksoi se nëse ATK dhe institucionet përkatëse do të shkëmbejnë informata atëherë **kostot e transaksionit për bizneset do të menjaheshin**. Gjithashtu është rekomanduar një koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve publike dhe universiteteve. Për shembull, Lulzim Sylja, pronar biznesi, sugjeroi një ndryshim lidhur me një licencë të lëshuar nga MTI për firmat në sektorin e energjisë ku **MTI aktualisht nuk i njeh diplomat Bachelor në inxhinieri** (të cilat sigurohen pas tri vite studimesh në sistemin e reformuar të edumit të lartë) dhe bizneset duhet të punësojnë inxhinier të cilët janë shkolluar në sistemin e kaluar (qoftë edhe vetëm për qëllim të "marjes në qera" të diplomave të tyre)

Problemet me lejet e ndërtimit, posaçërisht në Komunën e Prishtinës, shkaktohen kryesisht nga niveli i kompetencave teknike të punëtorëve (në të gjitha nivelet) dhe nga tendenca për korrupsion, tendencë e cila pjesërisht shkaktohet si rezultat i pagave të ulëta.

Muhamet Mustafa (Parlamenti i Kosovës) sugjeroi se duhet të krijohet një **grup lobimi** i asociacioneve të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile i cili do të bashkëpunonte me një Komision Parlamentar që do të adresonte çështjet e zhvillimit të sektorit privat.

Shkathtësitë e fuqisë punëtore

Lulzim Syla theksoi se ai has në probleme në gjetjen e elektrikistëve të kualifikuar dhe teknikëve të makinerisë, por ai gjithashtu shtoi se ka mungesë të punëtorëve të kualifikuar pothuajse në çdo profesion. Ai po ashtu theksoi nevojat në zhvillim e sipër dhe ato më emergjente në tregun e punës të cilat janë të lidhura me **ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", ku do të nevoiten 300 inxhinierë dhe mijëra teknikë**. Si zgjidhje, ai sugjeron që shkolla të reja të mesme profesionale të ndërtohen në të gjithë vendin; **kurrikulat e tyre duhet rishikuar në mënyrë që të reflektojnë nevojat e tregut të punës; ato shkolla të janë të pajisuar me laboratore dhe të furnizohen rregullisht me materiale shpenzuese për punë praktike. Në tryezë gjithashtu është cekur se edhe pjesa e fondeve që është alokuar për këto qëllime nuk është përdorur në mënyrë të përshtatshme nga institucionet publike**. Për shembull, në rastin e tenderëve të dhënë që firmat vendore të furnizojnë shkollat profesionale të mesme me materiale (shpenzues) për laboratore, vetëm 10% e vlerës aktuale të tenderit (dhe furnizimit) është implementuar dy vite pasi që është nënshkruar kontrata.

Ilir Rexha (GIZ) theksoi që një problem i madh në sektorin e edukimit profesional është pronësia dhe menaxhimi publik i **Qendrave për Trajnime Profesionale dhe që partneritetet publiko-private do të nxirrin rezultate më të mira**.

Ligji i punës

Një konsultant privat theksoi që ligji i punës është **keqinterpretuar nga Qeveria dhe se sektori privat është detyruar të përcjell këtë interpretim**. Ai argumenton se Parlamenti ka parashikuar që të jenë tetë orë pune në ditë, përjashtuar pushimin e drekës (i cili nuk paguhet). Gjysëm ora tjetër e pauzës në ligj i referohet dy pushimeve të shkurtër 15 minutësh gjatë orëve të punës (p.sh. për të pirë duhan ose për nevoja fiziologjike). **Prandaj është rekomanduar që Parlamenti të inicojë një interpretim të ligjit dhe të informojë publikun në interpretimin e duhur**.

AKB thekson që ligji i ri i punës ka **ndikar negativisht në punëtorët sezonalë**, posaqërisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe bujqësisë dhe se kjo duhet të diskutohet më tej.

Pagaminimale

Një përfaqësuesi biznesit privat theksoi se paga minimale prej 180 euro në muaj është e arsyeshme.

7. Referencat

- BQK, 2010. Raporti Vjetor 2009. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.
- Çavolli, V., 2011. Zhvillimi i sektorit të ICT-së. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011).
- Komisioni Evropian, 2010. Raporti Progresit për Kosovën 2010. Bruksel: Komisioni Evropian.
- Musa, L., 2011. Zhvillimi i sektorit privat. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011).
- Riinvest, vite të ndryshme. Zhvillimi i NVM-ve. Prishtinë: Instituti Riinvest.
- Riinvest, 2009. *Strategjia e industrisë*. Prishtinë: Instituti Riinvest.
- Rukiqi, B., 2011. Zhvillimi i sektorit privat. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011).
- Shahini, A., 2011. Zhvillimi i sektorit privat. [Intervistë]. (Komunikim personal, Maj 2011).
- Banka Botërore, 2010. *BEEPS 2008, Kosovo*. Washington, D.C: Banka Botërore.

Si organizatë private jofitimprurëse, Fondacioni Friedrich-Ebert është zotuar të promovojë idetë dhe vlerat themelore të demokracisë sociale. Demokracia sociale bazohet në të drejtat sociale të drejtat e njeriut dhe ato civile dhe synon t'i përfshijë ato. Ajo zgjeron dhe onsolidon bazën e demokracisë politike duke e përfshirë drejtësinë sociale, demokratizimin e shoqërisë, sigurinë sociale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe solidaritetin ndërkombëtar. Ajo mëton të sigurojë mundësi të barabarta në jetë dhe të drejtën për të pasur zë në çështjet e komunitetit të tyre për të gjithë ytetarët, burra dhe gra.



Prishtina Office
Kosovo, Prishtina, Mujo Ulqinaku str. 4/10
Tel : + 381 38 609 900 & 609 901
Fax + 381 38 609 902
e: contact@fes-prishtina.org
web: www.fes-prishtina.org

Rreth Institutit Riinvest

Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, operon që nga viti 1995 si organizatë hulumtuese, private jo-profitabile, me mision që ta promovoj zhvillimin modern ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Aktivitetet e Riinvestit gjatë viteve 1995-1997 ishin të fokusuar në organizimin e seminareve dhe uorkshopeve me ndërmarrës në çështje të ndryshme të mjedisit të biznesit dhe menaxhmentit të biznesit. Gjatë viteve 1997-1999 Riinvesti bëri aktivitete hulumtuese dhe përkrahëse të orientuara drejt rritjes së njohurive dhe informatave mbi faktorët vendor dhe ndërkombëtare në aspektet ekonomike të Kosovës. Gjatë periudhës së viteve 1999-2000 aktivitetet u orientuan drejt analizimit të situatave në sektorë të ndryshëm (NVM, bizneset familjare, SOE) dhe drejt një rikonstruktimi të suksesshëm. Që nga viti 2001 aktivitete kryesore përfshijnë hulumtimet mbi politikat dhe advokime për rritjen e mjedisit të biznesit dhe krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Ne jemi instituti i parë për zhvillim dhe kërkim i llojit think tank në Kosovë ne funksion që nga viti 1995. Ne promovojmë zhvillimin modern ekonomik në Kosovë bazuar në filozofinë e ndërmarrjeve. Ne kemi bërë publikime ekonomike dhe raporte me tematika shumë të rëndësishme që përfshijnë emrat e profesionistëve më të kualifikuar. Ne kemi krijuar partneritete me organizata të ndryshme botërore, kryesisht me ato të Amerikës Veriore. Ne organizojmë seminare, konferenca, tryeza diskutimi, dhe takime me rëndësi dhe vlerë të lartë ekonomike për Kosovën. Dituria dhe eksperiencia jonë na lejon që të kualifikohemi si ekspert në çdo fushë ekonomike. Me punën tonë, gjatë 2 dekadave të fundit, ne kemi shkruar historinë e vendit tonë mbi ekonominë, tregtinë, ndërmarrësi, dhe biznes.



Kosovo, Prishtina, Zona Industriale, 10000
Universiteti AAB-Riinvest, Godina 2, K 4
Tel: + 381 38 601 320 & 601 321
Fax: + 381 38 601 321
e: riinvest@riinvestinstitute.org
ëeb: ëëë.riinvestinstitute.org